



REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo



Agjencia për Ndhmë Juridike Falas
Agencija za Besplatnu Pravnu Pomoć
Agency for Free Legal Aid

KËSHILLI PËR NDIHMË JURIDIKE FALAS

AGJENCIA PËR NDIHMË JURIDIKE FALAS

ANJF-2013/2

RREGULLORE
PËR PROCEDURAT E PUNËS SË KOMISIONIT PËR ANKESA

Në përputhje me dispozitat e nenit 13 par.3, si dhe neneve 34 dhe 35,të Ligjit Për Ndhmë Juridike FalasNr. 04/L-017.

Duke pasur parasysh dispozitat e neneve 126 dhe 127 të Ligjit nr. 02/L-28, për Procedurën Administrative; Këshilli për Ndhmën Juridike Falas, në takimin e mbajtur me 08.02.2013, nxjerr:

RREGULLOREN
PËR PROCEDURAT E PUNËS SË KOMISIONIT PËR ANKESA

Neni 1

Qëllimi kryesor i nxjerrjes se kësaj Rregulloreje është rregullimi dhe përcaktimi i procedurave të punës së Komisionit për ankesa të Agjencisë për Ndhmën Juridike Falas, i cili ka për detyrë shqyrtimin e të gjitha ankesave të paraqitura nga parashtruesit, të cilëve ju është refuzuar kërkesa për lejimin e ndihmës juridike falas.

Neni 2

Çdo aplikues (palë) ka të drejtë të ankohet ndaj Vendimit për refuzimin e kërkesës për ofrimin e ndihmës juridike falas.

Neni 3

Ankesa ushtrohet në afatin prej tetë (8) ditëve, nga dita e pranimit të Vendimit për refuzimin e ndihmës juridike falas dhe i dorëzohet Zyrës Rajonale për Ndhmë Juridike ose Zyrës së Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë për Ndhmë Juridike Falas.

Neni 4

Ankesa adresohet në emrin e Komisionit për ankesa, në Agjencinë për Ndhmë Juridike Falas.

Neni 5

Përbërjen e Komisionit e emëronKNJF, i cili duhet të jetë i përbërë nga 3 anëtarë, Kryetari dhe 2 anëtar.

Neni 6

Zyra Rajonale, përkatësisht Zyra e Drejtorit Ekzekutiv, pasi që është njoftuar se aplikuesi e ka ushtruar ankesën kundër vendimit mbi refuzimin e ofrimit të ndihmës juridike falas, e njofton dhe menjëherë ankesën e dorëzon te Komisioni për Ankesa.

Neni 7

Kryetari i Komisionit për ankesa në afatin ligjor, e cakton datën e seancës për shqyrtimin e ankesës së ankuesit, dhe për këtë e njofton Zyrën e Drejtorit Ekzekutiv.

Neni 8

Komisioni i Ankesave nëse është e nevojshme, i mundëson ushtruesit të ankesës, që të arsyetojë ankesën e tij me prova materiale shtesë, mbi të drejtën për të qenë përfitues i ndihmës juridike falas.

Neni 9

Zyrtari i ndihmës juridike falas, i cili e ka marrë Vendimin për refuzimin e ofrimit të ndihmës juridike falas, do të merr pjesë në seancën e Komisionit për Ankesa në cilësinë e informuesit, pa të drejtë vote.

Neni 10

Komisioni për Ankesa, është i obliguar që të vendosë mbi ankesën në afatin prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita e pranimit të ankesës.

Neni 11

Pas shqyrtimit të ligjshmërisë dhe rregullsisë së aktit të kontestuar, Komisioni për ankesa merr vendimin me të cilin :

- a) hedhë ankesën si të palejuar;
- b) aprovon ankesën si të bazuar, prish vendimin me të cilin është refuzuar ndihma juridike falas dhe lejon ndihmën juridike falas, apo
- c) refuzon ankesën si të pabazuar.

Neni 12

Komisioni i Ankesave merr vendim me shumicën e votave, në seancë, dhe vota e Kryesuesit është vendimtare.

Neni 13

Në rast të mungesës së Kryetarit të Komisionit për Ankesa, kompetencat e tij kalojnë tek anëtari i Komisionit të cilin ai e autorizon.

Neni 14

Gjatë marrjes së vendimeve nga Komisioni i Ankesave, do të mbahet procesverbali. Procesverbali duhet të përmbajë: rendin e ditës, emrin dhe mbiemrin e anëtarëve prezent, diskutimet dhe deklaratat e anëtarëve të Komisionit dhe deklaratimet e ushtruesit të ankesës, në formë të shkruar si dhe çdo konkluzion tjetër të marrë në seancë.

Neni 15

Vendimi i Komisionit për Ankesa, është i formës së prerë kur nënshkruhet nga Kryetari apo anëtari i Komisionit të cilin e autorizon ai.

Neni 16

Kjo Rregullore hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryesuesi i Këshillit për Ndhmën Juridike Falas.

Më: 12. 03. 2013 Kryesues i Këshillit

Alban Sutaj